


Në mbështetje të Ligjit nr.03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, Ligjit 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare të Republikës së Kosovës, Ligjit të Punës nr.03/L-212 si dhe nenit 27 paragrafi 2 i Statutit të KRU "Hidromorava" Sh.A., Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidromorava" Sh.A., miraton këtë:



RREGULLORE
MBI ORGANIZIMIN E BRENDSSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS
NË KRU "HIDROMORAVA"- SH.A. Gjilan

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1.1. Me këtë Rregullore në KRU "Hidromorava" Sh.A., Gjilan (në tekstin e mëtejshëm: Kompania) rregullohet:

- 1.1.1. Organizimi i brendshëm;
- 1.1.2. Punët dhe detyrat e punës që kryhen në Kompani;
- 1.1.3. Emërtimi i grupeve të punëve, respektivisht detyrave të punës;
- 1.1.4. Kushtet e nevojshme për kryerjen e punëve të veçanta, respektivisht detyrat e punës;
- 1.1.5. Bazat për caktimin e numrit të nevojshëm të kryerësve të punëve,
- 1.1.6. Punët, respektivisht detyrat e punës, për të cilat bëhet verifikimi paraprak i aftësive të punëtorit;
- 1.1.7. Punët me orar jo të plotë;
- 1.1.8. Punët me kushte të posaçme të punës;
- 1.1.9. Punët të cilat kërkojnë kryesisht punë të rënda fizike dhe në të cilat nuk mund të punësohen të rinjtë nën moshën 18 vjeç dhe femrat;
- 1.1.10. Punët në të cilat kryesisht inkuadrohen personat me nevoja të veçanta;
- 1.1.11. Punët në të cilat mund të pranohen praktikantët si dhe
- 1.1.12. Sistematizimi i vendeve të punës, përshkrimi dhe kushtet për plotësimin e tyre.

Neni 2

Fushëveprimi

- 2.1. Kjo Rregullore zbatohet nga KRU "Hidromorava" Sh.A.
- 2.2. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës do të përcaktohet në atë mënyrë që siguron efikasitet më të lartë të mundshëm, racionalitet ekonomik dhe efektivitet në kryerjen e punës, për të gjithë të punësuarit të përcaktuar me ligje, akte nënligjore në fuqi dhe me këtë Rregullore.
- 2.3. Detyrat dhe përgjegjësitë e KRU "Hidromorava" Sh.A., janë të përcaktuara në mbështetje të Statutit të Kompanisë, Ligjit nr.03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 dhe Ligjit 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare të Republikës së Kosovës.

Neni 3

Baza për punësim dhe sistematizim

Vendet e punës të përcaktuara me këtë Rregullore paraqesin bazën për punësim dhe sistematizim, pranë KRU "Hidromorava" Sh.A.

Neni 4

Zyrtarët e lartë dhe të punësuarit në KRU "Hidromorava" dhe statusi i tyre

- 4.1. Statusi i zyrtarëve të lartë, konkretisht Kryeshefit Ekzekutiv, Zyrtarit të Lartë Financiar, Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm dhe Sekretarit, rregullohet me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Statutin e KRU "Hidromorava" Sh.A, si dhe me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
- 4.2. Statusi i të punësuarve në KRU "Hidromorava" Sh.A. përveç me këtë Rregullore, rregullohet edhe me Ligjin e Punës dhe me akte tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse.

- 4.3. Për Pozitat udhëheqëse (Drejtorët e Departamenteve, Menaxherët e Njësive Operative, Menaxherët e Divizioneve si dhe Shefat e Sektorëve) kontrata e punës do të lidhet me periudhë të caktuar prej tre (3) vjetësh, me mundësi vazhdimi varësisht nga performanca e tyre gjatë kësaj periudhe.

Neni 5

Koncepti i punëve

- 5.1. Me punë, respektivisht detyrat e punës nënkuptohet një grup operacionesh të njëjta ose të ngjashme, që i kryen një ose më shumë punëtorë gjatë kohës së punës.
- 5.2. Punët dhe detyrat e punës burojnë nga organizimi i procesit të punës dhe në rast të ndërrimeve të bëra në organizim, ato gjithsesi harmonizohen me ato ndërrime.
- 5.3. Secili grup i punëve dhe i detyrave që kryen i punësuar, ka emërtimin e vet. Emërtimi i grupit të punëve dhe të detyrave caktohet sipas përmbajtjes së punëve dhe detyrave, të cilat i punësuar është i obliguar t'i kryejë, me ç'rast përdoret terminologji e zakonshme.

Neni 6

Organizimi i brendshëm dhe funksionimi

- 6.1. Me organizim të brendshëm kuptohet ndarja e brendshme e punëve në Kompani, në harmoni me kërkesat e procesit të punës.
- 6.2. Me rastin e përcaktimit të organizimit të brendshëm të punëve dhe detyrave të punës dhe kushteve të veçanta për ushtrimin e tyre, si dhe numrit të kryesve, domosdo do të insistohet që të plotësohet kriteri i efikasitetit, funksionalitetit dhe racionalitetit në punën e Ndërmarrjes.
- 6.3. Strukturën organizative të ndërmarrjes e përbëjnë:
- 6.3.1. Bordi i Drejtorëve;
 - 6.3.2. Komisioni i Auditimit;
 - 6.3.3. Kryeshefi Ekzekutiv;
 - 6.3.4. Zyrtarët e Lartë;
 - 6.3.5. Drejtorët e Departamenteve;
 - 6.3.6. Menaxherët e Divizioneve përkatëse;
 - 6.3.7. Shef të Sektoreve Përkatëse;
 - 6.3.8. Menaxherët e Njësive Operative Kamenicë dhe Viti;
 - 6.3.9. Staf i profesional, administrativ dhe operativ i Kompanisë.

Neni 7

Organet Vendimmarrëse

- 7.1. Organe vendimmarrëse të Kompanisë janë: Bordi Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- 7.2. Funksioni dhe fushëveprimtaria e Bordit Drejtorëve është e përcaktuar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare Nr.06/L-016 dhe Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009.
- 7.3. Funksioni dhe fushëveprimtaria e Kryeshefit Ekzekutiv është përcaktuar me Statut të Kompanisë, me dispozita ligjore dhe kontratën e punës të miratuar nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 8

Hierarkia e raportimit

- 8.1. Kryeshefi Ekzekutiv udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe për punën e tyre i raportojnë drejtpërdrejtë Bordit të Drejtorëve.
- 8.2. Zyrtari i Lartë Financiar, udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv dhe për punën e tij i raporton drejtpërdrejtë Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.
- 8.3. Sekretari i Kompanisë, udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi Ekzekutiv dhe për punën e tij i raporton drejtpërdrejtë Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.
- 8.4. Zyrtari i Auditimit të Brendshëm, udhëhiqet nga Komisioni i Auditimit dhe për punën e tij i raporton drejtpërdrejtë Komisionit të Auditimit.
- 8.5. Drejtori Teknik, udhëhiqet dhe për punën e tij i raporton Kryeshefit Ekzekutiv.
- 8.6. Drejtori Komercial, udhëhiqet dhe për punën e tij i raporton Zyrtarit të Lartë Financiar.
- 8.7. Menaxherët e Njësiave Operative në Kamenicë dhe Viti, udhëhiqen dhe për punën e tyre i raportojnë Kryeshefit Ekzekutiv.
- 8.8. Menaxheri i Divizionit të Cilësisë së Ujit dhe Burimeve udhëhiqet dhe për punën e tij i raporton Kryeshefit Ekzekutiv.
- 8.9. Menaxheri i Divizionit për Planifikim dhe Menaxhim të Projekteve, Menaxheri i Divizionit për Prodhim – Impiantet e Ujit dhe Stacioneve të Pompimit, Menaxheri i Divizionit për Mirëmbajtjen të Rrjetit të Ujësjellësit, Menaxheri i Divizionit për Mirëmbajtjen e Ujërave të Ndotura, Menaxheri i Impantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN), udhëhiqen dhe për punën e tyre i raportojnë Drejtorit Teknik.
- 8.10. Menaxheri i Divizionit për Financa dhe Kontabilitet udhëhiqet dhe për punën e tij i raporton Zyrtarit të Lartë Financiar.
- 8.11. Menaxheri i Divizionit Komercial dhe Menaxheri i Divizionit për Shërbim të Konsumatorit udhëhiqen dhe për punën e tyre i raportojnë Zyrtarit të Lartë Financiar, përmes Drejtorit Komercial.
- 8.12. Departamenti Administrativ, Zyra Ligjore dhe Burimet Njerëzore udhëhiqet dhe për punën e tij i raportojnë Sekretarit të Kompanisë.
- 8.13. Shefat në kuadër të divizioneve/njësiave udhëhiqen dhe për punën e tyre u raportojnë menaxherëve të atyre divizioneve/njësiave.
- 8.14. Të punësuarit në kuadër të divizioneve udhëhiqen dhe për punën e tyre u raportojnë shefave të njësiave përkatëse dhe menaxherëve të divizioneve/njësiave përkatëse.

Neni 9

Kushtet për kryerjen e punëve të caktuara

- 9.1. Me rastin e rekrutimit të stafit, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, për çdo punë, respektivisht detyra punuese, me këtë Rregullore përcaktohen edhe kritere matëse për të zgjedhur kandidatin më të suksesshëm, të cilat duhet t'i plotësoj kandidati potencial.
- 9.2. Për kryerjen e punëve të caktuara dhe detyrave varësisht nga procesi i punëve, përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 9 mund të caktohen edhe kushte të tjera të posaçme të cilat punëtori duhet t'i plotësoj në aspekt të:
 - 9.2.1. përgatitjes shkollore – profesionale;
 - 9.2.2. përvojës së punës;
 - 9.2.3. njohuriave të posaçme;
 - 9.2.4. aftësiave të posaçme psikofizike;
 - 9.2.5. përshtatshmërisë për kryerjen e punëve;
 - 9.2.6. përgjegjësisë;
 - 9.2.7. ndërlikueshmërisë.

9.3. Përgatitja profesionale e duhur për kryerjen e punëve të caktuara, caktohet sipas llojit dhe ndërlikueshmërisë së punëve dhe të përgjegjësisë për kryerjen e tyre. Shkalla e nevojshme e përgatitjes shkollorë/profesionale, caktohet sipas punëve dhe detyrave më të ndërlikuara në grupin e caktuar të punëve. Përjashtimisht për kryerjen e punëve dhe detyrave të caktuara mund të parashihen si alternativë dy shkallë të afërta të përgatitjes shkollorë-profesionale.

9.4. Në bazë të kësaj Rregulloreje, për secilën pozitë punuese në Kompani, si minimumi i kualifikimit arsimor parashihet shkollimi i mesëm, përveç për punëtorët e pakualifikuar - punëtorët fizik, mjeshtrit e rrejtit të ujësjellësit, mjeshtrit e rrejtit të kanalizimit, , rojtarët dhe mirëmbajtësit/et të cilët mund të pranohen edhe me shkollim fillor.

Neni 10

Baza për përcaktimin e numrit të nevojshëm të të punësuarve

10.1. Numri i nevojshëm i punëtorëve për kryerjen e punëve dhe detyrave të caktuara, caktohet në bazë të analizimit të detyrave të planeve të Kompanisë dhe në bazë të Planit Vjetor të Biznesit.

10.2. Themelimi i marrëdhënies së punës apo caktimi i të punësuarve në vendet dhe detyrat e punës, bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë me Udhëzimin Administrativ MFFT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës.

Neni 11

Puna provuese

1. Puna provuese përcaktohet me Kontratën e Punës.
2. Puna Provuese mund të zgjasë, më së shumti gjashtë (6) muaj në pajtim Ligjin Nr. 03/L-212, të Punës dhe dispozitat e kësaj Rregullore.

Neni 12

Orari i punës

12.1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës i punësuari kryen punë ose shërbime për punëdhënësin.

12.2. Orari i punës për punëtorët administrativ të KRU "Hidromorava" Sh.A., është e hënë – e premte, duke filluar nga ora: 8:00 deri në ora 16:00. Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

12.3. Orari i punës për punëtorët operativ dhe rojtarët është si vijon: ndërrimi i paradites fillon nga ora: 7:00 deri në ora: 19:00, ndërrimi i pasdites fillon nga ora: 19:00 deri në ora 7:00 dhe pas çdo ndërrimi një ditë pushim, në bazë të sistemit të rotacionit.

12.4. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, konform nenit 56 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, si më poshtë:

12.4.1. 20 % për kujdestari;

12.4.2. 30 % për punë gjatë natës;

12.4.3. 30 % për punë jashtë orarit;

12.4.4. 50 % për punë gjatë ditëve të festave; dhe

12.4.5. 50 % për punë gjatë fundjavës

- 12.5. Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përfshijnë njëra-tjetrën.
- 12.6. I punësuar ka të drejtë që në vend të pagës shtesë sipas paragrafit 4 i këtij neni, të kërkojë të kompensohet me ditë pushimi;

Neni 13

Orari jo i plotë i punës

- 13.1. Orari jo i plotë i punës, është orar pune më i shkurtër sesa orari i plotë i punës.
- 13.2. Marrëdhënia e punës mund të themelohet me orar jo të plotë pune, në kohë të caktuar dhe të pacaktuar.
- 13.3. I punësuar i cili punon me orar jo të plotë pune, i gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sikurse i punësuar me orar të plotë pune, në proporcion me orët e punës që ka punuar i punësuar.
- 13.4. Marrëdhënia e punës, me së paku gjysmë orari të punës mund të themelohet për kryerjen e punëve në të cilat caktohen invalidët e punës, të cilët punojnë me orar të shkurtuar.
- 13.5. Me orar të shkurtuar mund të punësohen zyrtar edhe për shërbime për të cilat ka nevojë Kompania e për të cilat vëllimi i punëve është aq i vogël sa mbulohen edhe me punë me orar të shkurtuar, por jo më pak se 30% e orarit të plotë.

Neni 14

Puna me orar të shkurtuar

- 14.1. Puna me orar të shkurtuar caktohet për punët, për të cilat edhe përkundër aplikimit të masave mbrojtëse, i/e punësuar/a nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme për shëndetin e tij/saj.
- 14.2. Orari i punës shkurtohet në përpjesëtim me rrezikshmërinë për shëndetin dhe aftësinë punuese të punësuarit.
- 14.3. I/e punësuar/a i/e cili/a punon me orar të shkurtuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund të punojë në punë dhe detyra të njëjta jashtë orarit të punës.
- 14.4. I/e punësuar/a i/e cili/a punon me orar të shkurtuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, i gëzon të gjitha të drejtat, sikurse të kishte punuar me orar të plotë të punës.

I. SISTEMATIZIMI I VENDEVE TË PUNËS DHE KUSHTET E PLOTËSIMIT TË TYRE

Neni 15 Përkufizimi

- 15.1.** Sistematizimi i vendeve të punës është regjistër, respektivisht pasqyrë e punëve dhe detyrave dhe atë të: punëve udhëheqëse, koordinuese, profesionale, të përgjithshme, shërbyese, ndihmëse dhe punëve tjera të definuara dhe të përcaktuara sipas vendeve të punës, si formë themelore të procesit të punës.
- 15.2.** Me sistematizimin e vendeve të punës për çdo vend dhe funksion të punës, përcaktohen kushtet për kryerjen e tyre në aspekt të përgatitjes profesionale, përvojës e punës, si dhe kushteve e tjera të posaçme për kryerjen e punëve të caktuara.

Neni 16 Përvoja e punës varësisht nga pozita

- 16.1.** Varësisht nga pozita e punës, me rastin e rekrutimit, kërkohet përvojë profesionale dhe atë:
- 16.1.1.** Për pozitën Drejtor të Departamenteve: 5 vjet pune profesionale, së paku tri /3/ vjet përvojë pune në menaxhim në fushën përkatëse;
- 16.1.2.** Pozita Menaxher i Divizionit: 3 vjet përvojë pune profesionale, së paku /1/ vjet përvojë pune në menaxhim;
- 16.1.3.** Pozita shef i shërbimit: 2 vjet përvojë pune në profesion;
- 16.1.4.** Pozita koordinator: 2 vjet përvojë pune në profesion.
- 16.1.5.** Pozita zyrtar: 1 vjet përvojë pune në profesion.

Neni 17 Angazhimi i ekspertëve dhe bashkëpunëtorëve sipas nevojës së Kompanisë

- 17.1.** Për punët të cilat nuk mund t'i kryejnë punëtorët e Kompanisë, mund të angazhohen ekspertë dhe bashkëpunëtorë të profileve të ndryshme jashtë Kompanisë me kontrata të posaçme, varësisht prej nevojave të paraqitura në procesin e punës.
- 17.2.** Me sistematizimin e vendeve të punës mund të përcaktohen edhe punët për kryerjen e të cilave angazhohen bashkëpunëtorë dhe ekspertë përkatës të jashtëm, numri i të cilëve nuk është i kufizuar, si dhe punët e bashkëpunëtorëve tjerë që angazhohen me kontrata të posaçme.

II. EMËRTIMET E TITUJVE/VENDEVE TË PUNËS

Neni 18

Emërtimet e titujve/vendeve të punës

- 18.1. Vendet e punës të përcaktuara me sistematizim kanë emërtimet përkatëse të punëve që kryhen, si dhe numrin e caktuar të kryesve të nevojshëm.
- 18.2. Për vendet e punës në KRÛ "Hidromorava" Sh.A., përcaktohen këto emërtime të titujve të punës, grada, arsimimi i kërkuar, përvoja e punës e kërkuar dhe numri i pozitave sipas drejtorive/sektorëve/divizioneve/njësive dhe zyrave.

EMËRTIMET E TITUJVE/VENDEVE TË PUNËS

Shtojca 1

KRYESHEFI EKZEKUTIV

- | | |
|--|----|
| 1. Emërtimi i vendit të punës: Kryeshefi Ekzekutiv | 12 |
| 2. Emërtimi i vendit të punës: Asistent në Zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv | 13 |
| 3. Emërtimi i vendit të punës: Vozitës i automjetit të administratës | 14 |
| 4. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit | 14 |
| 5. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtari i furnizimit dhe prokurimit | 15 |
| 6. Emërtimi i vendit të punës: Koordinator për ujën e pa faturuar (UPF) | 16 |
| 7. Emërtimi i vendit të punës: Teknik për kontrollin dhe shkyçjen e lidhjeve të paautorizuara dhe ujit të pafaturuar | 16 |
| 8. Emërtimi i vendit të punës: Administrator i zyrës së teknologjisë informative – Zyrtar i TI-së | 17 |
| 9. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për raportim | 18 |
| 10. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për certifikim të pagesave | 18 |

Shtojca 2

DIVIZIONI I CILËSISË SË UJIT

- | | |
|---|----|
| 11. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher Regional i Divizionit për Cilësi të Ujit dhe Burimeve .. | 20 |
| 12. Emërtimi i vendit të punës: Laborant kryesor për analiza fiziko - kimike | 21 |
| 13. Emërtimi i vendit të punës: Laborant për analizat fiziko - kimike | 22 |
| 14. Emërtimi i vendit të punës: Laborant për analizat mikrobiologjike | 22 |
| 15. Emërtimi i vendit të punës: Teknik për mirëmbajtje dhe kontroll të klorit | 23 |
| 16. Emërtimi i vendit të punës: Mostrues | 23 |
| 17. Emërtimi i vendit të punës: Vozitës i automjetit të Divizionit për cilësinë e ujit dhe burimeve ujore | 24 |

Shtojca 3:

DEPARTAMENTI TEKNIK

18. Emërtimi i vendit të punës: Drejtör Teknik	26
19. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher Regional i Divizionit për Planifikim dhe Zhvillim të Projekteve	27
20. Emërtimi i vendit të punës: Shef i Seksionit të GIS-it	28
21. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për GIS-it	29
22. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për mbledhjen e të dhënave në terren	30
23. Emërtimi i vendit të punës: Shef i Menaxhimit të Projekteve	30
24. Emërtimi i vendit të punës: Inxhinier për Planifikim dhe Zhvillim	31
25. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher Regional i Divizionit për Prodhim/Impiantet e Ujit dhe Stacionet e Pompimit	32
26. Emërtimi i vendit të punës: Mbikëqyrës i pendave	33
27. Emërtimi i vendit të punës: Operator në Fabrikën e përpunimit të ujit (FPU) dhe Stacione të Pompimit	34
28. Emërtimi i vendit të punës: Rojtar në FPU	34
29. Emërtimi i vendit të punës: Mirëmbajtës i pajisjeve elektro mekanike	35
30. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher i Divizionit për Mirëmbajtjen e Rrjetit të Ujës-jellësit	36
31. Emërtimi i vendit të punës: Mjeshtër kryesor	36
32. Emërtimi i vendit të punës: Mjeshtër i rrjetit të ujës-jellësit	37
33. Emërtimi i vendit të punës: Punëtor i pakualifikuar – Punëtor fizik	38
34. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher i Divizionit për Mirëmbajtjen e Ujërave të Ndotura	39
35. Emërtimi i vendit të punës: Mjeshtër i rrjetit të kanalizimit	39
36. Emërtimi i vendit të punës: Vozitës i autocisternës dhe makinerive të rënda	40

Shtojca 4:

IMPIANTI I TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

37. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher i Divizionit të Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN)	41
38. Emërtimi i vendit të punës: Inxhinier Mekanik në Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN)	42
39. Emërtimi i vendit të punës: Inxhinier elektrik në Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN)	43
40. Emërtimi i vendit të punës: Kimist në Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN)	44
41. Emërtimi i vendit të punës: Mekanik në Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN)	45
42. Emërtimi i vendit të punës: Elektriciist në Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN)	45
43. Emërtimi i vendit të punës: Operator në Impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN)	46

44. Emërtimi i vendit të punës: Vozitës i autocisternës dhe makinerive të rënda në Impianitin e trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN).....	47
---	----

Shtojca 5:

AUDITORI I BRENDSHËM

45. Emërtimi i vendit të punës: Auditori i Brendshëm	48
--	----

Shtojca 6:

DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

46. Emërtimi i vendit të punës: Sekretar/e i/e Kompanisë.....	50
47. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe objekte	51
48. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar ligjor	52
49. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar i burimeve njerëzore	53
50. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për arkiv dhe protokoll	53
51. E Emërtimi i vendit të punës: Përgjegjësi i autoparkut.....	54
52. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për regjistrim dhe kontrollë të automjeteve	55
53. Emërtimi i vendit të punës: Punëtor i sigurimit në objektin e administrates së KRU "Hidromorava-s"	56
54. Emërtimi i vendit të punës: Mirëmbajtës/e/Pastrues/e	57

Shtojca 7:

DEPARTAMENTI FINANCIAR

55. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtari i Lartë Financiar	58
56. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher Regional i Divizionit për Financa dhe Kontabilitet.....	59
57. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar i kontabilitetit sintetik.....	60
58. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar i kontabilitetit analitik.....	61
59. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtari për mjete themelore	62
60. Emërtimi i vendit të punës: Depoist.....	62

Shtojca 8:

DEPARTAMENTI KOMERCIAL

61. Emërtimi i vendit të punës: Drejtor Komercial.....	64
62. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher i Divizionit Komercial.....	65
63. Emërtimi i vendit të punës: Shef i ekipit për ndërprerje (shkycje) të shërbimeve për shkak të borxheve.....	66
64. Emërtimi i vendit të punës: Teknik për ndërprerje (shkycje) të shërbimeve për shkak të borxheve	66
65. Emërtimi i vendit të punës: Faturist.....	67
66. Emërtimi i vendit të punës: Ndhmës faturist	68

67. Emërtimi i vendit të punës: Përgjegjës për shkarkimin e pagesave nga bankat dhe institucionet mikrofinanciare.....	68
68. Emërtimi i vendit të punës: Arkëtar kryesor.....	69
69. Emërtimi i vendit të punës: Arkëtar.....	70
70. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher i Divizionit të Shërbimit me Konsumatorë.....	70
71. Emërtimi i vendit të punës: Shef i Shërbimit me Konsumatorë.....	71
72. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për konsumatorë.....	72
73. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar në Qendrën e thirrjeve.....	73
74. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për legalizim të ujëmatësve.....	74
75. Emërtimi i vendit të punës: Lexues i ujëmatësve dhe Shpërndarës i faturave.....	75

Shtojca 9:

NJËSIA OPERATIVE NË KAMENICË DHE NJËSIA OPERATIVE NË VITI

76. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher i Njesisë Operative – Kamenicë/Viti.....	76
77. Emërtimi i vendit të punës: Përgjegjës i Operativës – Nj.O. – Kamenicë dhe Nj.O. – Viti.....	76
78. Emërtimi i vendit të punës: Shef i Seksionit të Shitjes – Nj.O. – Kamenicë dhe Nj.O. - Viti.....	78
79. Emërtimi i vendit të punës: Faturist – Nj.O. – Kamenicë/Viti.....	78
80. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për konsumatorë – Nj.O. Kamenicë/Viti.....	79
81. Emërtimi i vendit të punës: Arkëtar kryesor – Nj.O. – Kamenicë/Viti.....	80
82. Emërtimi i vendit të punës: Arkëtar – Nj.O. – Kamenicë/Viti.....	81
83. Emërtimi i vendit të punës: Lexues i ujëmatësve dhe Shpërndarës i faturës – Nj.O. – Kamenicë/Viti.....	82
84. Emërtimi i vendit të punës: Shef i Seksionit Teknik – Nj.O. – Kamenicë dhe Nj.O. - Viti.....	82
85. Emërtimi i vendit të punës: Mirëmbajtës i pajisjeve elektro mekanike - Nj.O. – Kamenicë dhe Nj.O. - Viti.....	83
86. Emërtimi i vendit të punës: Mjeshtër kryesor – Nj.O. – Kamenicë/Viti.....	84
87. Emërtimi i vendit të punës: Ujë instalues/Mjeshtër – Nj.O. Kamenicë/Viti.....	85
88. Emërtimi i vendit të punës: Operatör i mirëmbajtjes – Nj.O. – Kamenicë dhe Nj.O. - Viti.....	86
89. Emërtimi i vendit të punës: Vozitës i autocisternës dhe makinerive të rënda – Nj.O. – Kamenicë/Viti.....	86
90. Emërtimi i vendit të punës: Mirëmbajtës/e/ Pastrues/e – Nj.O. Kamenicë/Viti.....	87
91. Emërtimi i vendit të punës: Punëtor i pakuallifikuar – Punëtor fizik – Nj.O. Kamenicë/Viti.....	88
92. Emërtimi i vendit të punës: Teknik për mirëmbajtje dhe kontroll të klorit – Nj.O. – Kamenicë/Viti.....	88

Shtojca 1

KRYESHEFI EKZEKUTIV

1. EMËRTIMI I VENDIT TË PUNËS: Kryeshef Ekzekutiv

Përgatitja profesionale: Në harmoni me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087

Përvoja e punës: Në harmoni me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087

Numri i ekzekutuesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Të ketë njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Të ketë shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office është e detyrueshme.
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të zbatojë qëllimet strategjike dhe objektivat e Kompanisë duke i dhënë drejtim lidhshëm të drejtë arritjes së misionit dhe vizionit të Kompanisë;
- Mbështet punën e Bordit të Drejtorëve me anë të propozimeve lidhur me politikën dhe vendimet që do t'i merr Bordi;
- Është përgjegjës për shërbimet që ofron Kompania duke mbikëqyrur kualitetin e programit të përgatitjes së shërbimeve, marketingun dhe shitjes së këtyre shërbimeve;
- Propozon buxhetin vjetor për aprovim të Bordit të Drejtorëve, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Në mënyrë efektive menaxhon resurset njerëzore të Kompanisë brenda politikave zyrtare të kompanisë dhe procedurave konform ligjeve në fuqi;
- Siguron që misioni dhe programi i Kompanisë dhe i shërbimeve të saj, të jenë në mënyrë të vazhdueshme dhe fuqishëm të prezantuar për të krijuar një pasqyrim pozitiv të Kompanisë për palët e interesit;
- Mbikëqyrë ngritjen e fondeve, planifikimin dhe zbatimin e tyre, duke përfshirë identifikimin e burimeve të financimit, si dhe përgatitjen e strategjisë për të iu qasur këtyre burimeve duke ofruar propozim për administrimin dhe dokumentimin e ngritjes së këtyre fondeve;
- I propozon Bordit të Drejtorëve kandidat të përshtatshëm për punësim të Zyrtarit të Lartë Financiar dhe Sekretarit, duke sugjeruar të paktën dy (2) persona për secilin pozitë.
- I ofron Bordit të Drejtorëve të paktën një herë në tre muaj raporte për transaksionet kryesore të ndërmarra nga Kompania dhe për vendimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve të Kompanisë;
- I ofron Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund t'i kërkohej;
- I ofron Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund t'i kërkohej nga ana e tij;
- Menaxhon politikën dhe zbaton vendimet e Bordit të në pajtim me legjislacionin në fuqi;

- Biznesi, detyrat dhe organizimi i Kompanisë duhet të kryhet sipas direktivave, mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë së Kryeshefit Ekzekutiv, në pajtueshmëri me statutin dhe aktet ligjore të Kompanisë dhe vendimeve të Bordit të Drejtorëve.
- Të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e Kompanisë të cilat nuk janë në përgjegjësi të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, të Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit apo Zyrtarit të lartë të Auditimit të Brendshëm do të vendosen nga apo sipas direktivave dhe përgjegjësisë të Kryeshefit Ekzekutiv.
- Kryeshefi Ekzekutiv do të ketë autoritet të punësoj apo të largoj nga puna zyrtarët dhe stafin e Kompanisë duke i respektuar procedurat dhe dispozitat ligjore përkatëse si dhe të delegoj autoritetin e tillë tek zyrtarët e tjerë dhe anëtarët e tjerë, duke përfshirë Zyrtarin e Lartë Financiar, Zyrtarin e Lartë të Auditimit të Brendshëm dhe Sekretarin.
- Zbaton rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe kujdeset dhe siguron që stafi nën menaxhimin e tij/saj t'i zbatojë ato me përpikëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes.
- Për punën e tij/saj raporton dhe i përgjigjet Bordit të Drejtorëve.

2. Emërtimi i vendit të punës: Asistent në Zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv

Përgatitja profesionale/shkollëre: Diplomë universitare - fakulteti juridik, administratë publike, ekonomik e të ngjashme;

Numri i kryesve: /

Përvojë pune: Një /1/ vjet përvojë pune profesionale.

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Pranon thirrjet telefonike dhe porositë për Kryeshefin Ekzekutiv në mungesë të tij dhe për këtë e njofton Kryeshefin Ekzekutiv;
- Pranon palët e Kryeshefit Ekzekutiv dhe të njëjtit i evidenton në listën e takimeve;
- Kryen të gjitha punët administrative dhe është përgjegjës për pranimin dërgësive me vlerë, prej momentit të pranimit deri në momentin e dorëzimit personit të cilit i është destinuar apo punëtorit i cili është i autorizuar të bëjë dërgimin e dërgesës;
- Mbanë evidencën e urdhrave për furnizim me material zyrtar, kujdeset që materiali i nevojshëm të jetë i sigurt dhe për të njëjtin përgjigjet;
- Përgjigjet për punë, procesin e punës dhe mjetet të cilat i janë besuar;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes.
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj raporton dhe i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

3. Emërtimi i vendit të punës: Vozitës i automjetit të administratës

Përgatitja profesionale/shkollore: Shkolla e mesme.

Numri i kryesve: /

Përvojë pune: Së paku një /1/ vjet përvojë pune.

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës.
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Të posedojë patentë shoferi të kategorisë "B".

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Bënë transportimin e personelit kur ata kanë nevojë, gjegjësisht të materialit/ dokumentacionit;
- Bënë kontrollimin ditor të rregullsisë së automjetit;
- Eviton prishjet e vogla dhe bën ndërrimin e pjesëve të cilat ndërrohen lehtë;
- Bën pranim dorëzimit të materialit dhe dokumentacionit për transport;
- Mbanë evidencë të qarkullimit, shfrytëzimit të automjeteve dhe harxhimit të karburanteve;
- Rregullisht i arsyeton dëftesat për karburante;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj raporton dhe i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

4. Emërtimi i vendit të punës: Zvrtari përgjegjës i prokurimit

Përgatitja profesionale/shkollore: Diplomë universitare – fakulteti ekonomik, juridik, e të ngjashme.

Përvoja e punës: Së paku tre /3/ vjet përvojë pune profesionale në lëmin e prokurimit.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të jetë i certifikuar në lëmin e prokurimit;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme që kanë të bëjnë me punën e tij;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të procedurave;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Menaxhon dhe zhvillon zyrën e prokurimit;
- Pranon nga departamentet kërkesat për blerje dhe harton planet mujore dhe vjetore të blerjeve;
- Bënë vlerësimin profesional të ofertave në pajtim me procedurat sipas Ligjit të Prokurimit;

- Kryen hulumtimin e tregut të materialit, përcjellë dhe analizon rrjedhat e çmimeve dhe sasive në treg dhe në bazë të saj gjen zgjidhje më adekuate të furnizimit;
- Kontrakton dhe përcjellë realizimin e kontratave sipas Ligjit të Prokurimit;
- Mbanë evidencën e furnizuesve/sasitë, çmimet, kualitetin dhe dinamikën;
- Përkujdeset për prokurimin sipas planit dhe sipas kualiteteve të përcaktuara;
- Kontakton, pranon dhe kryen biseda afariste me partnerët e vet për prokurim;
- Kryen korrespondencën me partnerët afarist rregullisht dhe me kohë;
- Mbanë evidencën dhe përkujdeset mbi likuidimin e obligimeve ndaj furnizuesve;
- Përcjellë dhe studion dispozitat ligjore nga lëmin e prokurimit;
- Me kohë dhe afate ligjore kryen procedurat e ofertave (dosjeve të prokurimit) në harmoni me Ligjin e Prokurimit;
- Zbaton rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe kujdeset dhe siguron që stafi nën menaxhimin e tij/saj t'i zbatojë ato me përpikëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj raporton dhe i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

5. Emërtimi i vendit të punës: Zvrtar i furnizimit dhe prokurimit

Përgatitja profesionale/shkollore: Diplomë universitare – fakulteti ekonomik, juridik, e të ngjashme.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune profesionale në lëmin e prokurimit.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Të jetë i certifikuar në lëmin e prokurimit;
- Të ketë shkathtësi në të shkruar dhe aftësi të mira komunikimi;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Në bazë të bilancit të materialit nga departamentet e Kompanisë si dhe në bazë të gjendjes në depo, përpunon planet mujore dhe vjetore të blerjes;
- Sigurimi i vlerësimit profesional të ofertave në pajtim me procedurat sipas Ligjit të Prokurimit;
- Kryen hulumtimin e tregut të materialit, përcjellë dhe analizon rrjedhat e çmimeve dhe sasive në treg dhe në bazë të saj gjen zgjidhje më adekuate të furnizimit;
- Mbanë evidencën e furnizuesve/sasitë, çmimet, kualitetin dhe dinamikën;
- Përkujdeset për prokurimin sipas planit dhe sipas kualiteteve të përcaktuara;
- Kontakton, pranon dhe kryen biseda afariste me partnerët e vet për prokurim;
- Kryen korrespondencën me partnerët afarist rregullisht dhe me kohë;
- Mbanë evidencën dhe përkujdeset mbi likuidimin e obligimeve ndaj furnizuesve;
- Përcjellë dhe studion dispozitat ligjore nga lëmi i prokurimit;

- Me kohë dhe afate ligjore kryen procedurat e ofertimit (dosjeve të prokurimit) në harmoni me Ligjin e Prokurimit;
- Kryen furnizimin me material të Kompanisë nga ofertuesit të kontraktuar dhe ato të pa kontraktuar;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj raporton dhe i përgjigjet Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit.

6. Emërtimi i vendit të punës: Koordinator/e për ujin e pa faturuar (UPF)

Përgatitja profesionale/shkollore: Diplomë universitare – fakulteti i inxhinierisë ndërtimore – departamenti hidroteknikë dhe të ngjashme.

Përvoja e punës: Së paku tri (3) vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryeseve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përgatit raporte për performancën e ujësjellësve në gjithë zonën e shërbimit;
- Rekomandon masa për zvogëlimin e humbjeve të ujit;
- Angazhohet për respektimin e procedurave të punës gjatë evitimit të defekteve në terren;
- Përcjell investimet kapitale që realizohen nga donatorët apo dhe KRU-ja;
- Përgatit raporte të rregullta mujore dhe vjetore për zvogëlimin e humbjeve të ujit;
- Koordinon punën në mes të departamentit teknik, zyrës së konsumatorëve dhe zyrës së GIS-it;
- Merr pjesë aktive në zbatimin e planit për zvogëlimin e UPF-së të KRU "Hidromorava" Sh.A.
- Ndihmon në mbarrëvajtjen e punëve në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Zbaton rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe kujdeset dhe siguron që stafi nën menaxhimin e tij/saj t'i zbatojë ato me përpikëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj raporton dhe i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

7. Emërtimi i vendit të punës: Teknik për kontrollin dhe shqyçjen e lidhjeve të paatorizuara dhe ujit të pafaturuar

Përgatitja profesionale/shkollore: Shkolla e mesme

Përvoja e punës: Së paku një (1) vjet përvojë pune.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime shëndetësore;
- Të ketë njohuri praktike në sistemin e ujësjellësit dhe ujëmatësve;
- Gatishmëri për punë në terren dhe respektim të rregullave të sigurisë në punë.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Ushtron kontroll teknik dhe administrativ të lidhjeve të ujit dhe ujëmatësve;
- Identifikon dhe shkyç lidhjet e paautorizuara, manipulimet, keqpërdorimet dhe parregullsitë në konsum;
- Realizon kontrolle të rregullta dhe të rastit në terren, ndërrimin e ujëmatësve, evitimin e rrjedhjeve sipas planit të punës;
- Përgatit procesverbale, raporte kontrolli dhe evidenca për trajtim të mëtejshëm;
- Evidenton dhe dokumenton rezultatet e kontrolleve të realizuara;
- Bashkëpunon me strukturat teknike dhe vepron në koordinim të drejtpërdrejtë me Koordinatorin për UPF;
- Zbaton procedurat e brendshme, aktet normative dhe udhëzimet e eprorit;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe detyra të tjera të ndërlidhura me fushëveprimin e kontrollit, sipas kërkesës së Koordinatorës për UPF;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Koordinatorës për ujin e pafaturuar (UPF).

8. Emërtimi i vendit të punës – Administrator i zyrës së teknologjisë informative - Zyrtar i TI-së

Përgatitja profesionale/shkollëre: Shkolla e mesme

Përvoja e Punës: Së paku një (1) vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Preferohen certifikime të ndryshme në lëmin e TI-së (Cisco, Microsoft);
- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Njohuri të mira në instalime dhe mirëmbajtje të pajisjeve të TI-së;
- Instalime dhe mirëmbajtje të rrjetit lokal dhe VPN;
- Kualifikimet e tjera profesionale do të kenë përparësi;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Është përgjegjës për mbarëvajtjen e gjithë sistemeve të TI-së;

- Kujdeset për funksionin e të gjitha pajisjeve të teknologjisë informative për të krijuar një sistem funksional në përputhje me nevojat dhe kërkesat e KRU "Hidromorava" Sh.A.;
- Bën instalimin, konfigurimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të TI-së si: kompjuterë, lap-top, pajisje të rrjetit, printerë, skanerë, kamera të sigurisë, etj.
- Ofron mbështetje teknike për të gjithë punëtorët e KRU "Hidromorava" Sh.A.;
- Menaxhon dhe administron ueb faqen e KRU "Hidromorava" Sh.A. dhe siguron qasje të lehtë dhe kualitative për vizitorët si dhe siguron që përmajtja e ueb faqes të jetë e azhuruar gjatë gjithë kohës;
- Është i obliguar të kryej të gjitha punët e deleguara nga Kryeshefi Ekzekutiv;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj raporton dhe i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

9. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për raportim

Përgatitja profesionale/shkollore: Diplomë universitare – në shkencë sociale.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Të ketë shkathtësi në të shkruar drejtë dhe pa gabime dhe aftësi të mira të komunikimit;
- Njohuri bazike të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Të mos jetë i dënues me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Kualifikimet e tjera profesionale do të kenë përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përgatitë raportet mujore, tremujore dhe vjetore të punës së Kompanisë duke sintetizuar raportet e punës të dorëzuara nga departamentet dhe atë, nga ai i Financave, Departamentet Teknike, nga Zyra e Prokurimit dhe nga Departamenti Administrativ-Juridik;
- Raportet e aprovuara nga Bordi i Drejtorëve i dorëzon tek Aksionari përmes arkivit brenda afateve të parapara;
- Harton raporte sipas kërkesave të palëve të interesit: Menaxhmentit, Bordit të Drejtorëve, ARRU, ME-së, etj.
- Përpilon raporte periodike dhe vjetore sipas kërkesave të menaxhmentit dhe palëve të interesuara;
- Është përgjegjës për formalitetin dhe saktësinë e çdo raporti;
- Është përgjegjës dhe i obliguar që para palëve të interesuara të jap sqarime në çdo kohë lidhur me raportet e përpiluara;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj raporton dhe i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

10. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për certifikim të pagesave

Përgatitja profesionale/shkolllore: Diplomë universitare – fakulteti ekonomik.

Përvoja e punës: Së paku tri /3/ vjet përvojë pune profesionale në fushën e financave dhe kontabilitetit.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Njohja e sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme nga fushëveprimi i punës së tij;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë që më orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Në pajtim me mbikëqyrësin harton planin e punës për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të sektorit dhe jep rekomandime lidhur me objektivat e njësisë;
- Certifikon realizimin e të gjitha shpenzimeve buxhetore në Ndërmarrjen Publike;
- Siguron që shpenzimi i parashë së Kompanisë, donacioneve apo granteve të bëhet në pajtim me rregullat e Menaxhimit të Financave dhe Kontabilitetit dhe që prokurimi është në pajtim me Ligjin mbi prokurimin publik;
- Siguron që janë plotësuar kushtet e kontratës para se të bëhet pagesa dhe që kërkesa për pagesë është e koduar në zërin e duhur të shpenzimeve;
- Siguron që rregullat e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP) dhe dispozitat tjera ligjore janë respektuar gjatë inicimit dhe realizimit të aktivitetit të prokurimit dhe procedimit të shpenzimeve;
- Identifikon dhe raporton me shkrim Kryeshefin Ekzekutiv, mbi të gjitha rastet e mos respektimit të dispozitave ligjore për menaxhimin e financave publike dhe prokurimin publik;
- Përgatit raporte periodike konform Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe ligjeve tjera relevante;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj raporton dhe i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Shtojca 2

DIVIZIONI I CILËSISË SË UJIT

11. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher Regional i Divizionit për Cilësi të Ujit dhe Burimeve

Përgatitja profesionale/shkollore: Diplomë universitare – fakulteti i kimisë inxhinierike, apo teknologjisë ushqimore.

Përvoja e punës: 3 vjet përvojë pune profesionale, së paku /1/ vjet përvojë punë në menaxhim.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme nga fushëveprimi i punës së tij;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Bënë menaxhimin e cilësisë së ujit dhe burimeve ujore përmes monitorimit operacional të kualitetit të ujit me anë të analizave: fizik, kimike dhe mikrobiologjike.
- Bashkëpunon ngushtë me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK) dhe Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik Gjilan, analizon raportet dhe vërejtjet e përgatitura nga këto institucione;
- Siguron zbatimin e rregulloreve dhe udhëzimeve administrative në fuqi, që ka të bëjë me përgjegjësitë e KRU "Hidromorava" Sh.A. për kontrollimin e cilësisë së ujit sipërfaqësor, nëntokësor dhe ujit të pijshëm;
- Bashkëpunon me IKSHPK për monitorimin më efikas të kualitetit të ujit në aspektin mikrobiologjik;
- Analizon kornizën ligjore të aplikueshme dhe zbaton obligimet që ka KRU "Hidromorava" Sh.A. për monitorim dhe kontrollin e ujit në aspektin e cilësisë së ujit;
- Monitoron dhe planifikon shpenzimin e kimikateve dozuese për trajtim të ujit të papërpunuar si dhe bën porositë me kohë për sasi të nevojshme për të siguruar punë të pandërprerë të sistemeve;
- Monitoron raportet e cilësisë së ujit nga sistemet prodhuese, impiantet e trajtimit, rezervuarët si dhe raportet nga mostrat e marra në rrjetin shpërndarës tek konsumatorët final;
- Monitoron përcaktimin e dozimit të kimikateve në të gjitha pikat dozuese dhe propozon masat për dozim sa më efikas;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Sekretarit.

52. Emërtimi i vendit të punës: Mirëmbajtës/e/ Pastrues/e

Përgatitja profesionale/shkollore: Shkolla fillore.

Përvoja e punës: /

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Të ketë paraqitje të rregullt dhe sjellje të mirë;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Bën pastrimin dhe mirëmbajtjen e përgjithshme higjienike të lokaleve të punës të ndërtesës administrative;
- Kujdeset në mënyrë të veçantë për pastrimin e mirëmbajtjen higjienike të mureve, dritareve, dyshemesë dhe inventarit në zyre etj;
- Bënë pastrimin e dyshemesë, dezinfekton hapësirat, largon pluhurin nga inventari, bartë mbeturinat, letrat e përdorura etj.;
- Bën ajrosjen e lokaleve;
- Mirëmban pajisjet për pastrimin e objektit;
- Kryen shërbimin e kafeve për punëtorë dhe mysafirë;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe detyrat tjera të caktuara nga punëdhënësi konform detyrave punuese;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Sekretarit të Kompanisë.

Shtojca 7:

DEPARTAMENTI FINANCIAR

53. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtari i Lartë Financiar

Përgatitja profesionale/shkolllore: Në harmoni me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087

Përvoja e punës: Në harmoni me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087

Numri i kryeseve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të ketë aftësi të dëshnuara në menaxhim;
- Të ketë shkathtësi në të shkruar dhe aftësi të shkëlqyera komunikimi;
- Shkathhtësi në planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Të ketë njohuri të sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- Përparësi ka të jetë kontabilisti i certifikuar;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përgjigjet për të gjitha veprimet financiare të Kompanisë;
- Udhëheqë dhe këshillon gjithë personelin vartës për të siguruar rezultate të mira;
- Menaxhon çështjet financiare të Kompanisë, nën drejtimin dhe mbikëqyerjen e KE-së dhe Komisionit të Auditimit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Bënë mirëmbajtja e llogarisë së ndërmarrjes të azhuruar dhe të saktë;
- Bënë udhëheqjen e të gjitha kontrolleve të brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasuritë themelore;
- Monitoron llogaritë e pageshme dhe koordinon pagesën e faturave dhe blerjet speciale;
- Rishikon shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmëri me politikën e Kompanisë dhe buxhetin para pagesës së tyre;
- Përgatitë të dhënat e Kompanisë për auditim në fund të vitit;
- Koordinon funksionet e tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve të pajisjeve si dhe bashkëpunon me Kryeshefin Ekzekutiv dhe zyrën apo funksionin e prokurimit të ndërmarrjes;
- Menaxhon thesarin e ndërmarrjes, vendos dhe përgatit buxhetin dhe çfarëdo detyre tjetër financiare të përcaktuar nga Kryeshefi Ekzekutiv apo Bordi i Drejtorëve;
- Përgatitë dhe raporton për gjendjen financiare të ndërmarrjes në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Bashkëpunon me auditorin e jashtëm për çështje të auditimit dhe bënë implementimin e rekomandimeve të cilat dalin si rrjedhojë e një auditimi të brendshëm, të jashtëm ose nga çfarëdo organi tjetër këshillues apo ofrues i sigurisë;
- Obligohet për bashkëpunim të ngushtë me Kryeshefin Ekzekutiv, Drejtorin Komercial, Drejtorin Teknik dhe Menaxherët e Divizioneve;

- Ka për detyrë të nxjerr dhe planifikoj buxhetin dhe të vëzhgojë mospërputhjet;
- Të vëzhgojë/përcjellë qarkullimin e parasë së gatshme dhe transaksionet bankare;
- Udhëheqë dhe kontrollon të hyrat nga faturimi dhe mirëmbajtjen e të dhënave të konsumatorëve;
- Raporton të Bordit të Drejtorëve, lidhur me progresin financiar të Kompanisë planit aktual të biznesit, planit periodike dhe afatgjatë të shpenzimeve dhe aktiviteteve, fluksin e të hyrave dhe shpenzimeve;
- Kërkon, propozon dhe zbaton metoda dhe mënyra për të ndërtuar dhe përmirësuar metodat e punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve;
- Siguron se i gjithë personeli është i informuar me synimet dhe misionin e përbashkët të departamenteve, përkatësisht tërësisë së Kompanisë;
- Merr pjesë në mbledhjet e Komisionit të Auditimit dhe mbledhjet e Menaxhmentit;
- Përgatit të dhënat e Kompanisë për auditim në fund të vitit kalendarik;
- Formon komisionet për regjistrimet e fundvitit;
- Zbaton rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe kujdeset dhe siguron që stafi nën menaxhimin e tij/saj t'i zbatojë ato me përpikëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve.

54. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher Regional i Divizionit për Financa dhe Kontabilitet

Përgatitja profesionale/shkollore: Diplome universitare – fakulteti ekonomik.

Përvoja e punës: 3 vjet përvojë punë profesionale, së paku 1/1 vjet përvojë punë në menaxhim.

Numri i kryeseve: 1

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- Përparësi ka të jetë kontabilisti i certifikuar;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përgatit të dhënat financiare të Kompanisë për bilancin në fundvitit;
- Përcakton dhe zbaton zhvillimin e raportimeve kontabël/financiare;
- Përcjellë regjistrimin në kontabilitet;
- Shqyrton dhe aplikon ligjet dhe procedurat e ATK-së që rregullojnë çështjet tatimore dhe kujdeset për zbatimin me përpikëri të tyre;
- Bashkëpunon dhe raporton në ofrimin e të gjitha llogarive dhe raporteve që kanë të bëjnë me ATK-në dhe proceset e kontrollit që kryejnë institucionet tatimore;

- Analizon dhe raporton te dhënat financiare për drejtorin e Departamentit dhe drejtuesit e lartë në krijimin e planeve strategjike për të ardhmen;
- Interpreton informacionin financiar për të siguruar raportet e nevojshme për vendim-marrje të Bordit të Drejtorëve të Kompanisë;
- Kryen kontrollin regjistrimeve vjetore të materialeve, blerjeve dhe inventarin e tyre;
- Përcjell çdo ndryshim të planit kontabël;
- Organizon punën rreth harmonizimit të kontabilitetit financiar me atë material dhe zyrën e faturimit;
- Organizon regjistrimet e jashtëzakonshme të arkave dhe depove;
- Bënë ekzekutimin e pagesave të personelit në banka dhe kontabilitetin përkatës;
- Zbaton rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe kujdeset dhe siguron që stafi nën menaxhimin e tij/saj t'i zbatojë ato me përpikëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Zyrtarit të Lartë Financiar.

55. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar i kontabilitetit sintetik

Përgatitja profesionale/shkollore: Diplome universitare – fakulteti ekonomik.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregullorëve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kryen regjistrimin dhe procesimin e të gjitha faturave hyrëse dhe dalëse të Kompanisë, furnizuesve, bankave, etj.
- Kryen përshkrimin dhe likuidimin e faturave të Kompanisë në kohë;
- Kryen regjistrimet e pagesave;
- Përpilon pasqyrat e blerësve dhe furnizuesve në afate të caktuara;
- Përditëson dhe harmonizon librat kontabël me blerës dhe furnizues në afatet e caktuara ligjore;
- Shkruan dhe regjistron saktë, përgatit dhe mban dokumentet e regjistrimit të kontabilitetit;
- Përditëson në kohë të dhënat ditore të transaksioneve financiare në bazën e të dhënave;
- Hulumton, gjurmon dhe zgjidh problemet e mundshme dhe mospërputhjet kontabël ose të dokumentacionit;
- Informon menaxhmentin dhe barton raporte (përmbledhje mbi fushat e aktivitetit);
- Zbaton në përputhje të plotë standardet ndërkombëtare dhe kosovare të kontabilitetit, procedurat dhe ligjet financiare dhe ligjet tjera të aplikueshme;

- Përpilon librin e blerjes dhe të shitjes;
- Harmonizon në detaje dhe analitikë kontabilitetin financiar me atë material dhe zyrën e faturimit;
- Kryen kontrollin e dokumentacionit të gjithmbarshëm para kontimit dhe në rast të parregullsive njofton eprorin e Departamentit;
- Përcjellë çdo ndryshim të planit kontabël dhe e përpunon me udhëheqësin e sektorit;
- Punon në pastrimin e kontove, llogarive të arkëtuara dhe ato të paguara;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Menaxherit të Divizionit për Financë dhe Kontabilitet.

56. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar i kontabilitetit analitik

Përgatitja profesionale/shkollore: Diplome universitare – fakulteti ekonomik.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office;

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përgatitë dhe vendos shënimet e ditarit dhe kryen korrigjimet kontabël për të siguruar të dhënat e plota për sektorin që mbulon;
- Kryen menaxhimin e depos në përputhje me politikat dhe rregullat e Kompanisë;
- Mbikëqyrë marrjen, deponimin, shpërndarjen dhe operacionet e mirëmbajtjes dhe përdorimit të artikujve e materialeve;
- Planifikon, zbaton dhe siguron shfrytëzimin efikas të hapësirës së magazinës;
- Pajtohet me të gjitha kërkesat e legjislacionit për magazinimin, trajtimin dhe transportimin e artikujve dhe materialeve;
- Menaxhon kontrollin e aktiviteteve të biznesit dhe pajtohet me sistemin e ruajtjes së të dhënave;
- Planifikon aktivitete të punës, cakton detyrat në mënyrë të përshtatshme dhe vlerëson rezultatet;
- Prodhon raporte dhe statistika të rregullta për sektorin që e mbulon;
- Kryen kontrollime të regjistrimeve vjetore të materialeve, blerjeve dhe inventarin e tyre;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Menaxherit të Divizionit për Financë dhe Kontabilitet.

57. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për mjete themelore

Përgatitja profesionale/shkollëre: Diplome universitare – fakulteti i ekonomik.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Shkathitësi në komunikim planifikim të punës;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office;

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Është përgjegjës për mbikëqyrjen e pasurisë të paluajtshme dhe të luajtshme në Kompani;
- Bashkëpunon me drejtuesit e departamentit për pranimin e pasurisë së re dhe me zyrtarët e financave për sigurimin e të dhënave të sakta mbi emrin e pasurisë, përshkrimin fizik, prodhuesi, numri (lloji) i modelit, numri serial, numri i identifikimit (psh. targa), vendndodhja, statusi i përdorimit, gjendja aktuale, datën e pranimit, vlerat financiare, datën e pranimit, vlerat financiare, datën e tjetërsimit, numrin e faturës apo transaksioneve të tjera të lidhura;
- Bashkëpunon me punonjësit e logjistikës, furnizuesin, punonjësit e financave dhe punonjësit e tjerë sipas nevojës dhe sipas kërkesës ofron të dhëna mbi regjistrimin e vlerave të aseteve për nevoja të raportimit financiar;
- Në fund të çdo viti financiar dhe sipas nevojës regjistron dhe raporton të gjitha informatat mbi pasurinë në regjistrin e aseteve;
- Kryen identifikimin dhe përditësimin e plotë të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme në mënyrë periodike (çdo vit) gjithashtu edhe harmonizimin e tyre në Zyrën e GIS-it;
- Zbaton standarde të kontabilitetit mbi evidentimin dhe zhvlerësimin të aseteve;
- Zyrtari i pasurisë nuk mund të jetë anëtar i Komisionit për Regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë, nuk ka të drejtë të marrë vendim për çështjet që ndërlidhen me tjetërsimin e pasurisë, po ashtu nuk mund të jetë anëtar i Komisionit të verifikimit dhe inventarizimit të pasurisë;
- Përgatitë raport për gjendjen e pasurive të Kompanisë sipas kërkesës së drejtuesve financiarë;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Menaxherit të Divizionit për Financë dhe Kontabilitet.

58. Emërtimi i vendit të punës: Depoist

Përgatitja profesionale/shkollëre: Shkolla e mesme.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathësi në klasifikimin e duhur të materialit;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kryen detyrat e tij/saj në njësitë operative të Ndërmarrjes, sipas organizimit të brendshëm të punës dhe nevojave operative, në përputhje me aktet e brendshme të Ndërmarrjes.
- Kryen punët e detyrat e punës nga lëmi i pranimi, deponimi, ruajtjes dhe dhënies së mjeteve themelore, materialit dhe pjesëve rezervë, inventarit të imtë, auto-gomave dhe ambalazhit;
- Kryen pranimin kualitativ dhe kuantitativ të materialit në bazë të dokumentacionit përkatës,
- Kujdeset që mjetet themelore, materiali, pjesët rezervë dhe veglat të jenë të radhitura në bazë të njësi dhe në rregull;
- Në bazë të numrit kuantitativ i vërteton ndryshimet në mes të gjendjes reale dhe sipas dokumentacionit për të cilin e njofton eprorin e Departamentit;
- Pas pranimi të materialit përpilon fletëpranimin dhe ia përcjellë Departamentit komercial dhe personave përgjegjës;
- Kujdeset për ruajtjen kualitative dhe kuantitative të materialit, përpilon deponim listën në fund të çdo jave dhe ia dërgon Zyrtarit të Kontabilitetit Analitik në Departamentin e Financave;
- Jep material në bazë të dokumentacionit përkatës;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Menaxherit të Divizionit për Financë dhe Kontabilitet.

Shtojca 8:
DEPARTAMENTI KOMERCIAL

59. Emërtimi i vendit të punës: Drejtor Komercial

Përgatitja profesionale/shkolllore: Diplomë universitare – fakulteti i ekonomisë, menaxhiment dhe administrim biznesi dhe të ngjashme.

Përvoja e punës: 5 vjet pune profesionale, së paku tri /3/ vjet përvojë pune në menaxhim në fushën përkatëse.

Numri i kryeseve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të forinës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e sistemit të raportimit financiar;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Drejton, organizon dhe zbaton punët dhe detyrat e caktuara në Kompani në Departamentin Komercial si dhe të marrëdhënies me konsumatorë;
- Udhëheq dhe këshillon gjithë personelin vartës për të siguruar rezultate efektive;
- Drejton dhe përgatit të dhënat komerciale të kompanisë për planin e biznesit dhe raportet financiare për Bordin e Drejtorëve;
- Shqyrton dhe zbaton procedurat e aprovuara për sektorin komercial;
- Koordinon dhe bashkëpunon me Menaxhmentin në ofrimin e të gjitha të dhënave të aktivitetit të Departamentit në vartësi;
- Interpretin informacionin e sektorit të tij për të siguruar raportet e nevojshme për vendim marrje të Bordit të Drejtorëve të Kompanisë;
- Monitoron procesin e faturimit dhe shitjeve, nivelin e performancës në njësitë vartëse, llogaritë e debitorëve;
- Bën organizimin dhe zhvillimin e fushatave të informimit, ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për kursimin e ujit, ruajtjen e përdorimit të ujit të pijes dhe për kryerjen e pagesave me kohë;
- Sipas autorizimeve të Kryeshefit Ekzekutiv përfaqëson ndërmarrjen përpara palëve të interesit, ME, ARRU, etj;
- Sipas kërkesave, përpilon raporte mujore dhe vjetore për ARRU-në dhe institucionet qeveritare;
- Së bashku me Zyrtaren e Lartë Financiare koordinon aktivitetet rreth mirëmbajtjes së llogarive të arkëtueshme dhe kryen detyra të caktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv sipas fushës së kompetencës dhe pozitës;

- Zbaton rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe kujdeset dhe siguron që stafi nën menaxhimin e tij/saj t'i zbatojë ato me përpikëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i jep përgjegjësi Kryeshefit Ekzekutiv dhe Zyrtarit/es të Lartë Financiare.

60. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher i Divizionit Komercial

Përgatitja profesionale/shkollëre: Diplomë universitare – fakulteti i ekonomisë, menaxhment dhe administrim biznesi dhe të ngjashme.

Përvoja e punes: 3 vjet përvojë pune profesionale, së paku 1/ vjet përvojë punë në menaxhim.

Numri i kryesëve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Shkathhtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e sistemit të raportimit financiar;
- Kualifikimet e tjera profesionale është përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Udhëheq, organizon dhe zbaton punët dhe detyrat e caktuara në Kompani nga Drejtori i Departamentit Komercial, Zyrtares së Lartë Financiare dhe Kryeshefi Ekzekutiv;
- Udhëheq dhe këshillon gjithë personelin vartës për të siguruar rezultate efektive;
- Drejton dhe përgatit të dhënat komerciale të divizionit që mbulon për planin e biznesit dhe raportet financiare;
- Shqyrton dhe aplikon procedurat e aprovuara për divizionin komercial;
- Koordinon, kontakton dhe bashkëpunon në ofrimin e të gjitha të dhënave të aktivitetit të Departamentit në vartësi;
- Interpretin informacionin sektorial për të siguruar raportet e nevojshme për vendim marrje të drejtuesit të Departamentit, Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve të Kompanisë;
- Monitoron procesin e faturimit dhe shitjeve, nivelin e performancës në njësitë e varësisë, llogaritë debitorë;
- Sipas kërkesave përpilon raporte mujore/ tremujore dhe vjetore për menaxhimin e Kompanisë;
- Zbaton rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe kujdeset dhe siguron që stafi nën menaxhimin e tij/saj t'i zbatojë ato me përpikëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Drejtorit Komercial.

61. Emërtimi i vendit të punës: Shef i ekipit për ndërprerje (shkycje) të shërbimeve për shkak të borxheve

Përgatitja profesionale/shkollore: Diplomë universitare – fakulteti juridik, fakulteti ekonomik, administrim biznesi, e të ngjashme.

Përvoja e punës: Së paku dy (2) vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryeseve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Kualifikimet e tjera profesionale është përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Zbaton dhe aplikon mënyrën e punës, duke përfshirë procesin e dërgimit të vërejtjeve, realizimit të vizitave dhe shkycjes së konsumatorëve borxhlinj, sipas mënyrës së punës dhe organizimit të përcaktuar nga Menaxheri i Divizionit Komercial;
- Koordinon aktivitetet ditore të ekipeve të shkycjes për borxhe, në përputhje me planet operative dhe udhëzimet e miratuara;
- Siguron zbatimin korrekt të procedurave të shkycjes për borxhe, në përputhje me rregulloret dhe aktet nënligjore të Autoritetit Rregullativ për Ujëra (ARRU);
- Mëbikëqyr respektimin e procedurave ligjore, përfshirë njoftimin e konsumatorit, vërejtjen para shkycjes dhe dokumentimin e çdo rasti shkycjeje;
- Monitoron realizimin e shkycjeve dhe siguron raportimin e saktë dhe të plotë të rezultateve;
- Përpilon dhe dorëzon raporte mujore dhe vjetore lidhur me shkycjet për borxhe, sipas formatit dhe afateve të përcaktuara;
- Bashkëpunon me sektorët relevantë për trajtimin e rasteve të veçanta, në përputhje me udhëzimet e menaxhmentit;
- Zbaton rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe kujdeset dhe siguron që stafi nën menaxhimin e tij/saj t'i zbatojë ato me përpikëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së eprorit të drejtpërdrejtë, në përputhje me aktet e brendshme të kompanisë;
- Për punën e saj raporton dhe mban përgjegjësi para Menaxherit të Divizionit Komercial.

62. Emërtimi i vendit të punës: Teknik për ndërprerje (shkycje) të shërbimeve për shkak të borxheve

Përgatitja profesionale/shkollore: Shkolla e mesme

Përvoja e punës: Së paku një (1) vjet përvojë pune.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime shëndetësore;
- Të ketë njohuri praktike të sistemit të ujësjetllësit;
- Gatifshmëri për punë në terren dhe për zbatim të procedurave strikte operative;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Respektim i rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Ekzekuton shkyçjen e konsumatorëve borxhlinj nga sistemi i ujësjetllësit, në përputhje me procedurat e shkruara, aktet e brendshme dhe rregulloret e ARRU-së;
- Zbaton procesin e shkyçjes duke respektuar vërejtjen verbale, njoftimin paraprak për shkyçje dhe rregullat për shkyçje individuale dhe kolektive;
- Vepron bazuar në listat, autorizimet dhe planin e punës të Divizionit Komercial;
- Realizon vizita në terren te konsumatorët borxhlinj dhe ndërmerr veprimet përkatëse të shkyçjes;
- Dokumenton çdo rast shkyçjeje përmes procesverbaleve dhe evidencave përkatëse;
- Dorëzon raportet e shkyçjeve brenda afateve të përcaktuara te Shefja e Shkyçjes;
- Bashkëpunon me anëtarët e ekipit dhe respekton hierarkinë organizative;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës së eprorit të drejtpërdrejtë, në përputhje me rregulloret në fuqi;
- Për punën e tij/saj raporton dhe mban përgjegjësi para Shefes së Shkyçjes.

63. Emërtimi i vendit të punës: Faturist

Përgatitja profesionale / shkollore: Diplomë universitare – fakulteti ekonomik.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës.
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Është përgjegjës kryesor për kategorinë e konsumatorëve biznese të mëdha dhe institucione;
- Menaxhon komplet procesin e kontratave të veçanta për dhënie të shërbimeve me kategoritë biznese të mëdha dhe institucione në bashkëpunim me shërbimin e konsumatorëve;
- Përgatit specifikimet mujore për gjithë konsumatorët e bizneseve dhe institucioneve publike;

- Kontrollon shërbimin e faturimit mbi saktësinë e gjendjeve dhe vlerave për biznese të mëdha dhe institucione;
- Monitoron përmirësimet e gabimeve në faturim, sipas procesverbaleve nga komisioni i ankesave dhe kërkesave, komisionet, vendimet e ARRU-së, vendimet e gjykatave;
- Është përgjegjës për barazimin e kartelave financiare me konsumatorët e bizneseve të mëdha dhe institucioneve dhe komplet menaxhimin e llogarive të arkëtueshme për këto kategori;
- Përcjell faturimin për konsumatorët për të cilët është përgjegjës, krijon fatura për raste specifike;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i jep llogari dhe i përgjigjet Menaxherit të Divizionit Komercial.

64. Emërtimi i vendit të punës: Ndihmës faturist

Përgatitja profesionale/shkollore: Shkolla e mesme.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune.

Numri i kryeseve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës.
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Ndihmon Faturistin Kryesor në menaxhimin e procesit të kontratave të veçanta për dhënien e shërbimeve me kategoritë biznese të mëdha dhe institucione në bashkëpunim me shërbimin e konsumatorëve;
- Së bashku me Faturistin Kryesor përgatit specifikimet mujore për gjithë konsumatorët e bizneseve dhe institucioneve publike;
- Ndihmon Faturistin Kryesor në monitorimin e përmirësimeve të gabimeve në faturim, sipas procesverbaleve nga komisioni i ankesave dhe kërkesave, komisionet vendimet e ARRU-së, vendimet e gjykatave;
- Ndihmon Faturistin Kryesor për barazimin e kartelave financiare me konsumatorët e bizneseve të mëdha dhe institucioneve dhe komplet menaxhimin e llogarive të arkëtueshme për këto kategori;
- Përcjell faturimin për konsumatorët për të cilët është përgjegjës, krijon fatura për raste specifike;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i jep llogari dhe i përgjigjet Menaxherit të Divizionit Komercial.

65. Pozita dhe detyrat e punës: Përgjegjës për shkarkimin e pagesave nga bankat dhe institucionet mikrofinanciare

Përgatitja profesionale/shkollore: Shkolla e mesme

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës.
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i punëve dhe përgjegjësi

- Shkarkon dhe merr me kohë të dhënat mbi pagesat nga bankat dhe institucionet mikrofinanciare;
- Verifikon përputhjen e pagesave me listën e konsumatorëve dhe borxheve përkatëse;
- Identifikon dhe raporton pagesat e pasakta ose të paqarta (pa referencë, me shumën e gabuar etj.);
- Regjistron pagesat në sistemin e faturimit;
- Përgatit raporte ditore, javore dhe mujore mbi arkëtimet nga bankat dhe institucionet mikrofinanciare;
- Bashkëpunon me sektorin e kontabilitetit për mbylljen e bilanceve;
- Komunikon me bankat dhe institucionet mikrofinanciare për zgjidhjen e mospërputhjeve;
- Respekton rregullat e sigurisë së informacionit dhe ruan të dhënat për auditim;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Divizionit Komercial.

66. Pozita dhe detyrat e punës: Arkëtar krvesor

Përgatitja profesionale/shkollore: Shkolla e mesme profesionale.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës.
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës

- Bën arkëtimin në para të gatshme në bazë të urdhërave, faturave për të gjitha shërbimet dhe punët të cilat Kompania i kryen klientëve;
- Pranon nga Përgjegjësi i pikave të arkëtimit pazarin ditor me specifika të pazarit të arkëtuar;
- Udhëheq ditarin e arkës dhe bën raportin e arkës çdo ditë;
- Çdo ditë dorëzon pazarin ditor në bankë;
- Ruan dokumentet të cilat i janë besuar arkëtarit;
- Kontrollon rregullsinë e të gjitha dokumenteve në bazë të cilave bëhet grumbullimi i mjeteve dhe pagesave;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Përgjegjësit të pikave të arkëtimit dhe Menaxherit të Divizionit Komercial.

67. Emërtimi i vendit të punës: Arkëtar

Përgatitja profesionale/shkollore: Shkolla e mesme profesionale.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës.
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kryen arkëtimin në para të gatshme në llogari të Kompanisë nga konsumatorët;
- Asiston në procesin e faturimit dhe inkasimit;
- Bën arkëtimin e mjeteve nga punëtorët inkasues;
- Bën dorëzimin e përditshëm të mjeteve të arkëtuara të udhëheqësit të njësisë në arkën kryesore;
- Bën komunikimin me konsumatorë në mënyrë transparente dhe efektive;
- Kryen edhe detyrat tjera të cilat mund të jenë të përshkruara në përshkrimin e bashkëngjitur të punës ose të caktuara ngapunëdhënësi;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj përgjigjet Përgjegjësit të pikave të arkëtimit dhe Menaxherit të Divizionit Komercial.

68. Emërtimi i vendit të punës: Menaxher i Divizionit të Shërbimit me Konsumatorë

Përgatitja profesionale/shkollore: Diplomë universitare - fakulteti ekonomik, juridik, shkencë sociale dhe të ngjashme.

Përvoja e punës: 3 vjet përvojë pune profesionale, së paku /1/ vjet përvojë punë në menaxhim.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë më orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Njohja e sistemit të raportimit financiar;
- Kualifikimet e tjera profesionale është përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Mbikëqyrë stafin e sektorit të marrëdhënieve me konsumatorë;
- Udhëheq komunikimin me konsumatorë që të jetë sa më transparent dhe efikas, duke u përgjigjur ndaj kërkesave të konsumatorëve;
- Planifikon procedurën e informimit me kohë të konsumatorëve për të drejtat dhe obligimet e ndërsjella me Kompaninë;
- Krijon mundësi të mira për parashtrimin e kërkesave dhe ankesave të konsumatorëve, trajtimin dhe vendosjen/zgjidhjen adekuate të tyre, si dhe njoftimin me kohë për zgjidhjen e tyre;
- Organizon dhe zhvillon fushata të informimit, ndërgjegjësimit dhe edukimit publik për mbrojtjen e resurseve ujore, kursimin e ujit të pijes dhe për t'u bërë pagesat me kohë;
- Zhvillon procedura të nevojshme eficiente për menaxhimin efikas të shërbimeve për konsumatorë në përputhje me rregullat e ARRU-së;
- Mban kontakte të vazhdueshme me ARRU-në, si dhe përcjell në mënyrë të vazhdueshme e raportet e kërkuara nga kjo zyrë;
- Kujdeset për zbatimin e Ligjit si dhe rregullave që i nxjerr ARRU në bazë të të cilave rregullohen raportet e ofruesit të shërbimeve të ujit dhe kanalizimit me konsumatorin;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislationin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Drejtorit Komercial.

69. Emërtimi i vendit të punës: Shef i Shërbimit për Konsumatorë

Përgatitja profesionale: Diplomë universitare – fakulteti ekonomik dhe të ngjashme.

Përvoja e punës: Së paku dy /2/ vjet përvojë pune profesionale.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Kualifikimet e tjera profesionale është përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Organizon punën në kuadër të shërbimit të konsumatorëve, koordinon punën me shërbimet dhe departamentet tjera të Kompanisë, përgatitë planet dhe raportet për ecurinë dhe vijueshmërinë e punëve në ngritjen dhe përmirësimin e standardeve të shërbimeve ndaj klientëve;
- Zbaton autorizimet e marra nga eprori i drejtpërdrejtë dhe udhëheqësit tjerë të Kompanisë në realizimin e synimeve strategjike të Kompanisë lidhur me ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve e njëkohësisht edhe përmbushjen e kërkesave financiare dhe realizimin e pagesave;
- Jep autorizime dhe detyra pune vartësve dhe zyrtarëve në kuadër të divizionit konform përgjegjësi dhe ligjit;
- Koordinon punën me komisionin dhe zyrtarët për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, duke kërkuar që ato t'i zgjidhin drejtë dhe me afat dhe përcjellë më lartë preokupimet dhe sfidat e komisionit me qëllim të përmirësimit dhe ofrimit të ndihmës në kuadër të kompetencave;
- Kujdeset që punët në shërbim të kryhen konform ligjit, rregullave të ARRU-së si dhe rregullave dhe procedurave të KRU "Hidromorava" Sh.A. Gjilan;
- Në bashkërendim me zyrtarin ligjor, mund të merr pjesë në mbledhje të komisionit këshillues të konsumatorëve të ARRU-së;
- Jep rekomandime dhe zbaton aktet normative për rregulloret e aprovuara nga ARRU-ja;
- Harton planin e pushimeve vjetore dhe propozon stimulimin e punëtorëve në raste të caktuara;
- Bënë kërkesat për furnizime me material zyrtar dhe plotësimin e kushteve të nevojshme të punës të punësuarve;
- Zbaton rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe kujdeset dhe siguron që stafi nën menaxhimin e tij/saj t'i zbatojë ato me përpikëri, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Menaxherit të Divizionit për Shërbim me Konsumatorë.

70. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar për konsumatorë

Përgatitja profesionale: Shkollë e mesme.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekto dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;

- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës.
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Udhëheq procedurat për paraqitjen e kycjeve të reja në shërbime të ujit dhe kanalizimit nga konsumatorët;
- Udhëheq procedurat për zgjidhjen e ankesave dhe kërkesave të ujit dhe kanalizimit;
- Njofton konsumatorët lidhur me ndërprerjet të ujit;
- Zbaton procedurat për marrëveshje të riprogramimit të pagesës së borxhit;
- Zbaton procedurat formale për rastet emergjente për të kontaktuar dhe për të ofruar këshilla konsumatorëve;
- Komunikon vazhdimisht me konsumatorë duke iu përgjigjur kërkesave të tyre dhe i udhëzon lidhur me procedurat të cilat duhet ndjekur për të parashtruar ankese/kërkesa konform ligjit dhe rregulloreve të brendshme të kompanisë;
- Ankesat/kërkesat e pranuar nga konsumatorët i procedon në departamentet përkatëse duke raportuar në baza ditore/javore dhe përkujdeset për zbatimin e afatëve ligjore si dhe rregulloreve të aprovuara nga KRU "Hidromorava";
- Informon me kohë konsumatorët për të drejtat dhe obligimet e ndërsjella me Kompaninë;
- Pranon ankesat me shkrim dhe kompletin dosjet për Komisionin e Ankesave;
- Ndihmon arkivën në sisteminim e dosjeve të konsumatorëve;
- Zbaton Procedura të nevojshme eficientë për menaxhimin efikas të relacioneve me konsumator në përputhje me rregullat e ARRU-së dhe aplikimi i Ligjit, si dhe rregullave që i nxjerrë ARRU në bazë të të cilave rregullohen raportet e ofruesit të shërbimit;
- Zbaton me përpikëri rregullat, procedurat dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të Ndërmarrjes;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj përgjigjet Shefit të Zyrës për Konsumatorë dhe Menaxherit të Divizionit për Shërbim me Konsumatorë.

71. Emërtimi i vendit të punës: Zyrtar në qendrën e thirrjeve

Përgatitja profesionale – Shkolla e mesme.

Përvoja e punës: Së paku një /1/ vjet përvojë pune.

Numri i kryesve: /

Kushtet e veçanta:

- Të ketë sjellje të rregullt, korrekte dhe profesionale në ushtrimin e detyrave të punës;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë;
- Të jetë i aftë për punë me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës.
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësiave të punës:

- Pranon të gjitha ankesat/kërkesat nga konsumatorët përmes thirrjeve telefonike dhe ato kërkesa i adreson në departamentet përkatëse;
- Telefonon konsumatorët për mos përmbushjen e obligimeve të cilat i kanë ndaj kompanisë;
- Fton konsumatorët dhe i informon për mundësinë e riprogramimit të borxhit;
- Përcjellë zbatimin e marrëveshjeve për riprogramim borxhi (falja e borxheve, riprogramime);
- Njofton konsumatorët për mos përmbushje të marrëveshjes;
- Njofton konsumatorët për shkycje;
- Përpilon raportet javore, mujore lidhur me konsumatorët e papërgjegjshëm të cilët janë kontaktuar etj;
- Ndihmon arkivën në sistemimin e dosjeve të konsumatorëve;
- Njohja rregulloreve të brendshme të Kompanisë si dhe të ARRU-së;
